



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 5080/ Prot.  
71

Pogradec, më 26.12.2024

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim dhe miratim

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar znj. Kryetare,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim Projekt -Vendimin për:

**“ MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË  
POGRADEC DHE NDËRMARRJEVE NË VARËSI ”**

Me respekt,

KRYETAR  
Ili XHAKOLLI

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (dy)

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues: 3 ( tre)

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 8 ( tetë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. \_\_\_\_ .Prot

Datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

PROJEKT- VENDIM

NR. \_\_\_\_, DATË \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

PËR

**“MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË  
POGRADEC DHE NDËRMARRJEVE NË VARËSI”**

Në mbështetje të; nenit 13, nenit 108, nenit 109, nenit 113 të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomisë vendore" të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore"; Ligjit Nr.8480, date 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administrates shtetërore dhe enteve publike"; shkronjës "ç" dhe shkronjës "dh" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; neni 5 dhe neni 9 i Ligjit Nr. 35/2023 i ndryshuar "Për kompetencat për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve të institucioneve të administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi"; Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 142, datë 12.3.2014, i ndryshuar "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 328, datë 31.5.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore"; i ndryshuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 503, datë 01.08.2024 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", bazuar në dokumentacioni i paraqitur dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,




## KËSHILLI BASHKIAK

### VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të pagave për funksionarët, nëpunësit civilë, punonjësit administrative dhe punonjësit e shërbimit të Bashkisë Pogradec, Njësive Administrative, punonjësve të Policisë bashkiake si dhe Ndërmarrjeve në varësi, sipas tabelave nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Efekte financiare do të fillojnë prej datës **1 Janar 2025**.
3. Të gjitha vendimet e mëparshme të Këshillit të Bashkisë Pogradec, që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij vendimi, shfuqizohen dhe /ose anulohen.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar pranë Bashkisë Pogradec, si dhe Ndërmarrjet në varësi të saj.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

**KRYETARE E KËSHILLIT**

**Manjola KAMOLLI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA POGRADEC**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**  
**SEKTORI I MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE ÇËSHTJEVE ADMINISTRATIVE**

Pogradec, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

## **RELACION**

### **MBI PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË ADMINISTRATËS SË BASHKISË QËNDER, NDËRMARRJEVE NË VARËSI DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE**

E nderuar Kryetare i Këshillit,

Të nderuar Këshilltarë,

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 328, date 31.05.2023 për “Klasifikimin e Funksioneve, Grupimin e Njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 503, datë 01.08.2024 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore

Projekt-vendimi që po ju paraqesim bazohet në Vendimin e mësipërm të Këshillit të Ministrave dhe është i domosdoshëm për të përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në gërmën ”ç” të nenit 54 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar, ku shprehet se Këshilli i Bashkisë “ miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emeruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi ”.

Sipas të dhënave të Gjëndjes Civile numri i banorëve të Regjistrimit të Gjëndjes Civile për vitin 2024 është 91951 banorë, Bashkia Pogradec grupohet në kategorinë e Njësive të Qeverisjes Vendore



me 50 001-100 000 banorë, ku numri i banoreve përcakton klasat, kategorinë dhe nivelin e pagave për çdo pozicion pune.

Në lidhje me nivelin e pagave për nëpunësin civil i jemi referuar lidhjes nr. 5 të VKM-së 503, datë 01 Gusht 2024.

Paga e administratorëve të njësive Administrative, sipas numrit të banorëve, i referohemi lidhjes nr. 8 të Vkm-së 503, datë 01 Gusht 2024.

Shtesa për vjetërsi në punë jepet në masën:

- 0.6 % pas çdo viti pune për 10 vjet vitet e para ( 1-10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 0.8 % pas çdo viti pune për 10 vjet vitet e dyta ( 11-20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 1 % pas çdo viti pune për 10 vjet vitet e treta ( 21-30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

*Për efekt të llogaritjes së shtesës së vjetërsisë, "vite pune", do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, msipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudhës së me pagesë papunësie,*

Paga e Punonjësve me Kod Pune:

Për punonjësit me Kod Pune jemi bazuar në diskutimin që është bërë midis Shoqatës së Bashkive, Ministrisë së Pushtetit vendor dhe Ministrisë së Financave, ku u diskutua mbi nivelin e ri te pagave. Në orientimin që morëm, për këta punonjës i jemi referuar lidhjes nr.5 të Vkm-së 305 datë 01.08.2024.

Paga e Punonjësve Administrative dhe vjetërsia:

- Për punonjësit administrative të Bashkise Qender dhe Njesive të vetqeverisjes vendore, kufijtë e pagave bazë është nga 40 000 deri në 47 000 mijë lekë në muaj.
- Punonjësit administrativë, përveç pagës bazë, përfitojnë shtesën për vjetërsi në punë. Kjo shtesë aplikohet në masen 1 % mbi pagën bazë të përcaktuar për çdo klasë.
- Për llogaritjen e kësaj shtese merret për bazë vjetërsia e përgjithshme, por jo më shumë se 25 vjet.

Niveli i Kualifikimit:



- Niveli i kualifikimit sipas kornizes shqiptare te kualifikimeve është sipas lidhjes nr. 9 të VKM-se 503, date 01.08.2024

Shtesa për kushte ( natyrë të veçantë në punë):

- Sipas vkm-së 328 datë 31.05.2023, shtesa për kushte pune ( natyrë të veçantë në punë), 5 000 mijë ( pesë mijë ) lekë në muaj, për punonjësit e strukturave të TIK-ut, të bashkive deri në 100 000 banorë,

Në zbatim të VKM - së 503, datë 01.08.2024 efektet financiare fillojnë nga data 01.01.2025.



**NIVELI I PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË POGRADEC DHE  
NDËRMARRJEVE NË VARËSI TË SAJ**

Tabela nr. 1 -

**Niveli i pagës për funksionarët në Bashkinë e Pogradecit**

<b>EMËRTIMI</b>	<b>Paga, I Zgjedhur/ I emëruar</b>	<b>Niveli/Min / Maks</b>
<b>Kryetar i Bashkisë</b>	260,000	205 000 –260 000
Zv/ Kryetar i Bashkisë	205,000	170,000 —205,000
Administrator Nj.A.Pogradec 20.001-50.000 banorë	110,000	80 000 –155 000
Administrator Nj.A.Buçimas 20.001-50.000 banorë	110,000	80 000 –155 000
Administrator Udënisht, Çerrave 5.001 – 20.000 banorë	110,000	65 000 -145 000



Administrator Nj.A. Proptisht, 5.001 – 20.000 banorë	105,000	65 000 -145 000
Administrator Nj. A Velçan, Trebinjë, Dardhas Deri në 5.000 banorë	105,000	65 000 -140 000

**Tabela nr. 2 -**

**Niveli i pagës për nëpunësit civilë në Bashkinë e Pogradecit**

KATEGORIA	KLASA	EMËRTESA E POZICIONIT	GR. DIPLOMËS	PAGA PËR POZICION	SHTESA PËR POZICION
1	2	3	4	5	6
I	I-IV	Sekretar i Përgjithshëm	1	95,000-180,000	180,000
II	II-2	Drejtor i Kabinetit, Sekretar i Këshillit Bashkiak	1	85,000 141,000	141,000
II	II-2	Drejtor Drejtorie,	1	85,000 141,000	141,000
III	III-2	Koordinator	1	70,000 -105,000	105,000
III	III-2	Këshilltar i Kryetarit,	1	70,000 -105,000	105,000
III	III-2	Përgjegjës Sektori	1	70,000 -105,000	87,000
III	III-3	Përgjegjës niveli A	1	65,000 -98,000	77, 000
III	III-3	Përgjegjës niveli B	1	65,000 -98,000	72,000
IV	IV-2	Specialist	lose 2 ose 3	45,000 -80,000	70,000
IV	IV-3	Specialist, Koordinator vendor	lose 2 ose 3	42,000-70,000	64,000



IV	IV-4	Specialistë	1 ose 2 ose 3	40,000 -60,000	52,000
----	------	-------------	------------------	----------------	--------



**Tabela nr. 3**


**Niveli i pagës për Punonjësit dhe Punonjësit administrtive te Bashkisë**

Nr.	Emërtimi	Niveli Minimal/Maksimal  Kod pune	PAGA	Vjetërsia
1	Përgjegjës Sektori	65,000 -98,000	72 000	1 %
2	Inspektor	42,000-70,000	65 000	1 %
3	Punonjës (sekretariati KB)	40,000 -60,000	57 000	1 %
5	Koordinator lagje	40,000 -60,000	57 000	1 %
6	Punonjës Administrativ (shërbimi ,magaznier, shofer, roje)	40 000- 47 000	47 000	1 %

**Tabela nr. 4**

**Niveli i pagës për Punonjësit e Qendres Komunitare**

Nr.	Emërtimi	Niveli Minimal/Maksimal  Kod pune	PAGA	Vjetërsia
1	Psikolog, Logopedist, Fizioterapist	40,000 -60,000	57 000	1 %
2	Koordinator per PAK	40,000 -60,000	55 000	1 %
3	Kujdestar	40,000 -60,000	50 000	1 %
4	Punonjes sherbimi	40 000- 47 000	47 000	1 %



**Tabela nr. 5**

**Niveli i pagës për punonjësit e Njësive Administrative**

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Niveli Minimal/Maksimal</b>	<b>PAGA</b>	<b>Vjetërsia</b>
1.	Punonjës Arkiv-protokoll, punonjës per NE, Koordinator për komunitetin dhe mbrojtjen e tokës	42,000-70,000	55 000	1 %
2.	Përgjegjës i shërbimeve	42,000-70,000	60, 000	1 %
3.	Punonjës (Pastruese, Roje, Punëtor, shofer, elekticist, hidraulik)	40 000-47 000	47, 000	1 %


**Tabela nr. 6**

**Niveli i pagës për administratën në Qendra Arsimore**

<b>Kategoria</b>	<b>Klasa</b>	<b>Emërtesa e Pozicionit</b>	<b>Gr. Diplomës</b>	<b>Paga për Pozicion</b>	<b>Shtesapër pozicion</b>
II	II-2	Drejtor	1	85,000 - 141, 000	141, 000
III	III-3	Përgjegjës Niveli A	1	65 000- 98 000	77, 000
III	III-3	Përgjegjës, Çerdhe Niveli B	1	65, 000 – 98, 000	72, 000
IV	IV-3	Specialiste	1 ose 2 ose 3	42, 000 – 70, 000	57, 000

**Tabela nr. 7**

**Niveli i pagës për punonjësit mbështetës, Qendra Arsimore**



Nr.	Emërtimi	Niveli Minimal/Maksimal	PAGA	Vjetërsia
1	Kujdestare Çerdhe	40,000-60 000	55,000	1 %
2	Magaznier	40,000-47,000	47,000	1 %
3	Kuzhiniere	40,000-47,000	47,000	1 %
4	Ndihmës Kuzhiniere	40,000-47,000	47,000	1 %
5	Punonjes sherbimi	40,000-47,000	47,000	1 %

Tabela nr. 8

Niveli i pagës për Administratën e Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Infrastrukturave & Punëve Publike

Kategoria	Klasa	Emërtesa e Pozicionit	Gr. Diplomës	Paga për Pozicion	Shtesa për pozicion
II	II-2	Drejtor	1	85,000 – 141,000	141,000
III	III-2	Përgjegjës i degës ekonomike, juridike, urbane.	1	70,000 – 105,000	87,000
III	III-3	Përgjegjës sektori, Niveli B	1	65,000 – 98,000	72,000
IV	IV-2	Specialist, Jurist, Ekonomist	1 ose 2 ose 3	45 000 – 80 000	64 000
IV	IV-3	Specialist, Protokoli Arkive	1 ose 2 ose 3	40 000-70 000	52 000



Tabela nr. 9

Niveli i pagës për punonjësit e Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Infrastrukturave & Punëve Publike

Nr.	Emërtimi	Niveli Minimal/Maksimal	PAGA	Vjetërsia
1	Përgjegjës sektori (i mesëm)	40 000-65 000	55 000	1%
2	Manovratorë I+II	40 000-65 000	65 000	1%
3	Shofer Kamionist, Brigadier	40 000-65 000	50 000	1%
4	Magaznier	40 000-65 000	55 000	1%
5	Punëtorë (teknik ndërtimi, shofer, elektrikist, hidraulik, saldator, marangoz, usta ndërtimi, bojaxhi, mekanik)	40 000-65 000	50 000	1%
6	Punonjës për dekorin	40 000 - 50 000	50 000	1%
7	Punëtorë shërbimi (Punëtorë kanalizimi, roje, punëtorë varrezash, Pastruese)	40 000- 47 000	47 000	1%

Tabela nr. 10

Niveli i pagës për Administratën e Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit

Kategoria	Klasa	Emërtesa e Pozicionit	Gr. Diplomës	Paga për Pozicion	Shtesa për pozicion
II	II-2	Drejtor	1	85,000 – 141,000	141 000
III	III-3	Përgjegjës Sektori, Niveli A	1	65,000 – 98,000	77 000
III	III-3	Përgjegjës Sektori, Niveli B	1	65,000 – 98,000	72 000

IV	IV-2	Jurist	1 ose 2 ose 3	45 000-80 000	64 000
----	------	--------	---------------	---------------	--------

Tabela nr. 11

Niveli i pagës për punonjësit Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit

Nr.	Emërtimi	Niveli Minimal/Maksimal	PAGA	Vjetërsia
1	Brigadier	40 000- 60 000	55 000	1%
2	Magaznier	40 000-47 000	47 000	1%
3	Punëtorë (Hidraulik, Shofer, lulishtare, pompist, krasites	40 000-47 000	47 000	1%

Tabela nr. 12

Niveli i pagës për punonjësit Ndërmarrjes së Mbrojtjes së Territorit

Kategoria	Klasa	Emërtesa e Pozicionit	Gr. Diplomës	Paga për Pozicion	Shtesa për pozicion
II	II-2	Drejtor	1	85,000 – 141,000	141,000
III		Kryeinspektor	1 ose 2 ose 3	70,000 - 105,000	105,000
		Jursit,ekonomist	1 ose 2 ose 3	45 000 -80 000	64,000
		Magaznier		40 000-47 000	47,000
		Inspektor i Policisë Bashkiake		45,000 - 80,000	70,000

		Punonjës i Policisë Bashkiake		45,000 - 80,000	65,000
		Pergjegjes sektori,		65,000 - 98,000	72 000
		Inspektor (ndertimi, mjedisi, konsumatori)		42 000-70 000	65 000
		Punonjës (Inspektor)		40,000 - 60,000	57 000
		Punonjes sherbimi per kujdesin e geneve endacake)		40 000-47 000	47 000
		Specialiste	1 ose 2 ose 3	42 000-70 000	64 000

Hartoi: Specialist Sektori

Jugerta Zharri

Miratoi: Drejtor

Laura Elmasllari

Konfirmoi: Sekretar i Pergjthshem

Dritan Babasuli

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI